



Banka Evropiane
e Investimeve | Globale

Aktiviteti i Grupit të BEI-t në BALLKANIN PERËNDIMOR në vitin 2023

- BEI Globale, krahu i zhvillimit të Bankës Evropiane të Investimeve (BEI), investoi 1,2 miliardë euro në Ballkanin Perëndimor në vitin 2023, duke mobilizuar një total prej mbi 6 miliardë eurosh në investime.
- Ky financim u përqendrua në infrastrukturën e qëndrueshme, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe në tranzicionin e drejtë drejt ekonomive të dekarbonizuara.
- Për të rritur sigurinë rrugore dhe për të përmirësuar rrjetet hekurudhore, BEI Globale investoi rreth 700 milionë euro në projektet e transportit ekologjik në rajon.



Në vitin 2023, BEI Globale, krahu i investimeve, i dedikuar për vendet dhe rajonet përtej përtej Bashkimit Evropian, shënoi një rekord të ri kreditimi prej 1,2 miliardë eurosh në Ballkanin Perëndimor. Pjesa më e madhe e financimit u shpërnda për lidhje të qëndrueshme, të pasuara nga linjat e kredisë për NVM-të, projektet e infrastrukturës në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe aftësive, si dhe ujësjetllës-kanalizime. Me një vlerë prej 475 milionë eurosh në grante të nënshkruara në kuadër të [kornizës së investimeve të Ballkanit Perëndimor \(KIBP\)](#) dhe [nismës për rimëkëmbje ekonomike](#), BEI Globale shfaqti përfitimet e marrëveshjeve të favorshme financiare dhe mbështetjes teknike në partneritetet e Team Europe.

BEI Globale vijoi të avancojë zbatimin e [planit ekonomik dhe investimeve të Komisionit Evropian](#) dhe [nismës Global Gateway](#), duke mirëpritur gjithashtu [planin e rritjes, të miratuar rishtazi për Ballkanin Perëndimor](#). Këto masa tregojnë përkushtimin e palëkundur të Bashkimit Evropian ndaj procesit të anëtarësimit të rajonit në BE, integritet të tregut dhe zhvillimit socio-ekonomik.



Hedhja e themeleve për tranzicionin e drejtë të gjelbër

Rritja e mbështetjes teknike për dekarbonizimin e ekonomive rajonale

BEI Globale ka vijuar të jetë faktor kyç në tranzicionin e gjelbër të rajonit përmes rritjes së investimeve në energjinë e ripërtërishme, modernizimin e infrastrukturës së energjisë dhe nismave për efikasitetin energjetik. Me prezantimin e qasjes së saj të re për një tranzicion të drejtë dhe rimëkëmbje, sipas paraqitjes në konferencën e ndryshimeve klimatike COP28, banka synon të rrisë shërbimet e saj financiare dhe këshilluese në Ballkanin Perëndimor për të siguruar rezultate pozitive socio-ekonomike në lidhje me dekarbonizimin.

Në kuadër të [nismës për rajonet e qymyrit në tranzicion](#), BEI Globale po mbështet partnerët e saj rajonalë në përcaktimin e strategjive, programeve dhe projekteve për të zbutur pasojat e tranzicionit me karbon të ulët. Do të ofrohet gjithashtu asistencë teknike shtesë në kuadër të programit këshillimor JASPERS të BEI dhe Komisionit Evropian, siç u njoftua në vitin 2023.

Banka i është bashkuar edhe deklaratës për platformën e investimeve në tranzicion të drejtë për Maqedoninë e Veriut. Kjo platformë synon të mobilizojë deri në 3 miliardë euro në investime, politika dhe asistencë teknike, me qëllim përshpejtimin e vendosjes në punë të kapacitetit të ri të energjisë së rinovueshme prej 1,7 gigavat deri në vitin 2030.

Nxitja e rritjes, dekarbonizimit dhe punësimit gjithëpërfshirës të bizneset e vogla

Grupi i BEI-t ka investuar deri më sot mbi 6 miliardë euro në sektorin privat të rajonit

Grupi i BEI-t luan një rol të rëndësishëm në rritjen e sektorit privat, konkurrencën dhe krijimin e vendeve të punës, duke mundësuar financime të përballeshme për NVM-të. Me financimin prej 275 milionë eurosh të bankës në vitin 2023, së bashku me mbështetjen nga bankat vendase dhe institucionet kombëtare për zhvillim, bizneset e vogla do të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre për likuiditet dhe investime dhe të punojnë drejt objektivave të tyre të masave për klimën.

Në vitin 2023, BEI u nderua gjithashtu me çmimin "Uxolo" për linjën e saj të kreditimit me ndikim social. Kjo nismë është njohur si një mjet financiar novator, duke kontribuar në punësimin e të rinjve, barazinë gjinore dhe praktikatat shoqërore gjithëpërfshirëse. Së bashku me Fondin Evropian të Investimeve, ofruesi kryesor i Bashkimit Evropian për financimin e rrezikut për NVM-të dhe kapitalin e mesëm, BEI ka investuar mbi 6 miliardë euro në sektorin privat të rajonit, që përbën rreth 40% të totalit të kredisë së saj deri më sot. Sipas [studimit mbi ndikimin e kreditimit të ndërmjetësuar të BEI-t për bizneset në Ballkanin Perëndimor](#), NVM-të regjistruan përmirësime të konsiderueshme. Totali i asetëve u rrit me 20%, asetet fikse me 35% dhe punësimi me 15%, që korrespondon me rreth 15 vende pune shtesë për çdo 1 milion euro kredi të dhënë nga BEI.



Përmirësimi i infrastrukturës së arsimit, ujit dhe shëndetësisë

Rreth 700 milionë euro të destinuara për projekte të transportit të qëndrueshëm në vitin 2023

BEI Globale siguroi 695 milionë euro për modernizimin e rrjeteve të transportit në Ballkanin Perëndimor në vitin 2023. Këto investime mbulojnë projekte si ndërtimi i seksioneve hekurudhore Beograd–Nish në Serbi dhe Kriva-Pallanka deri në kufirin bullgar në Maqedoninë e Veriut. Gjithashtu, banka vazhdoi investimin në modernizimin e transportit urban në Sarajevë dhe projektet e rehabilitimit të rrugëve në Serbi.

Për të përmirësuar cilësinë e jetës në rajon, BEI Globale ofroi afërsisht 115 milionë euro për përmirësimin e shkollave dhe objekteve mjekësore. Këto fonde u dhanë për modernizimin e njësive të kujdesit shëndetësor dhe ndërtimin e një kampusi të ri mjekësor në qendrën klinike universitare të Banja-Lukës. Ato gjithashtu do të ndihmojnë në ndërtimin, rinovimin dhe pajisjen e objekteve arsimore në të gjithë Serbinë, duke forcuar trajnimin dhe arsimin profesional të lartë në vend.

Programi kombëtar i arsimit malazez vazhdoi gjithashtu të përfitonte nga mbështetja e BE-së. Fondet e BEI-t kontribuan në ngritjen e ndërtesës së Institutit "BioSense" në Serbi, e cila u hap në vitin 2023 me objekte të avancuara që shtrihen në rreth 7000 m² me qëllim kërkimor dhe sipërmarrje biznesi.

Akses më i mirë në ujë të pijshëm

Me 76 milionë euro grante në kuadër të nismës së KIBP-së, Maqedonia e Veriut do të marrë financim për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, i cili do t'u shërbejë rreth 500 000 frymëve në Shkup. Këto fonde do të ndihmojnë gjithashtu 20 komuna në Bosnjë-Hercegovinë që të kenë akses në ujë të pijshëm dhe shërbime sanitare. BEI do të ofrojë gjithashtu mbështetje teknike për bashkinë e Tiranës për të përshpejtuar zbatimin e rrjetit të ujësjellësit.



Arritjet e përgjithshme të Grupit të BEI-t në vitin 2023

Financimi i përgjithshëm i Grupit të BEI-t

Projekte të nënshkuara nga Grupi i BEI-t, me vlerë

88 miliardë euro

Financimi i projekteve të gjelbra

61%

e të gjitha financimeve të nënshkuara nga Grupi i BEI-t
lidhen me masat për klimën dhe qëndrueshmërinë
mjedisore

Projekte të nënshkuara nga BEI Globale për Ballkanin Perëndimor

me vlerë **1,2 miliardë euro**

Kredi të BEI-t me vlerë

750 milionë euro

dhe grante të nënshkuara në vitin 2023 me vlerë

475 milionë euro

Projekte të nënshkuara nga Grupi i BEI-t për Ballkanin Perëndimor që nga viti 2010

me vlerë **10,2 miliardë euro**

Numri i vendeve të punës të ruajtura që nga viti 2009
falë financimit të BEI-t tejkaloi

900 000

KONTAKTET E SHYTYPIT

Gordana Kovačević

+381 60 323 3435

+381 11 3121756

g.kovacevic@ext.eib.org

Përfaqësia rajonale për

Ballkanin Perëndimor

Vladimira Popovića 38, Beograd

+381 11 3121756

b.belgradeoffice@eib.org

Sekretariati i shtypit

+352 4379-1

+352 4379-61000

press@eib.org

www.eib.org/press

PIKA TË PËRGJITHSHME KONTAKTI

Banka Evropiane e Investimeve

98-100 boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

Zyra e Informacionit

+352 4379-1

+352 4379-62000

info@eib.org – www.eib.org